



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

VENDIM

Nr. 14_ Data_04.08.2017_

Për mos miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uJOR në lumin Pavlë dhe Leshnicë në pjesën fundore para bashkimit të tyre, si edhe shkarkimet e rezervuarit të Janjarit, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "SELEVAN" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Finiq, fshati Qesarat, Qarku Vlorë, subjektit “ Wonder” sh.p.k., me administrator Znj. Olimbi Gjika

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit UJOR”, Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjensisë së Basenit UJOR”; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 “Vënie në dijeni”**,

VENDOSI

Mos miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit uJOR në lumin Pavlë dhe Leshnicë në pjesën fundore para bashkimit të tyre, si edhe shkarkimet e rezervuarit të Janjarit, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "SELEVAN" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Finiq, fshati Qesarat, Qarku Vlorë, subjektit “ Wonder” sh.p.k., me administrator Znj. Olimbi Gjika me këto të dhëna:

Koordinatat: X4434136; Y4402291; Z 120
X4430137; Y4405418; Z118
X4431208; Y4402654; Z117

Prurja mesatare : 1.9 m3/sek
1.58 m3/sek
0.97 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

Prurja e llogaritur: 2.7 m³/sek
2.3 m³/sek
2.2 m³/sek

Prurja e ekologjike: 0.029 m³/sek
0.024 m³/sek
0.015 m³/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritetet të jetë **1840 kW**

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”

Ilir PROFKA

KRYETAR I K.B.U “VJOSË”

Etjona HOXHA